



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 36, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“EUROSIG” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të shoqërisë “Eurosig” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2024, sipas përllogaritjes së shoqërisë.
2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2024 të provigjoneve teknike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:

Provigjonet teknike në 31 dhjetor 2024	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	3,804,337,952
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	309,975,238
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	3,494,362,714

3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI